



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 09-2008
Prishtinë, më 10 prill 2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Kolë Berisha, Riza Smaka, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Džezair Murati.

Munguan: Branislav Grbiq, Melihate Tërmkolli dhe Selvije Halimi.

Të ftuarit: Paul Miller-UNHR, Agon Vrenezi-UNHR, Orsolya Szekely-Këshilli i Evropës, Lumnije Murati-ZPK, Reshit Gashi-NDI, Ramadan Islami-OSBE, Lejla Selimi-OSBE, Robert Steere-NCSC, Yordan Sirakov-EUPT, Fitore Zeneli-KDI.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Behlul Zeka dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 25 marsit 2008
3. Formimi i Komisionit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit
4. Njoftimi për angazhimin e ekspertëve për shqyrtimin e Projektligjit për procedurën përmbareuese dhe të Projektligjit për procedurën jokontestimore
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndërmjetësimin
6. Shqyrtimi i projektligjeve për bazë juridike në Kornizën Kushtetuese
7. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 25 marsit 2008

Kryetari – I pyeti anëtarët për vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Formimi i Komisionit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit

Kryetari - Theksoi se në këtë pikë do të prezantojnë edhe mysafirët nga Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht, shefi i zyrës, Paul Miller.

Paul Miller – I prezantoi para Komisionit elementet për përcaktimin e kritereve përzgjedhëse për Avokatin e Popullit, duke u përqendruar në pesë pika: 1. përshtatshmëria personale, 2. arsimimi, 3. përvoja, 4. njohuritë, 5. aftësitë.

Kryetari - E falënderoi përfaqësuesin nga Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut dhe shtoi se këto elemente, materialet e tjera të ofruara nga Zyra, si dhe mbështetësit e tjerë, do të merren parasysh me rastin e punës së panelit që do të formohet nga Komisioni. Fjalën ia dha zyrtarit, Nexhat Jashari, nga Zyra e Personelit të Kuvendit të Kosovës.

Nexhat Jashari – I sqaroi rregullat e miratuara nga Kuvendi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe fazat që do të kalojnë gjatë zgjedhjes. U ndal sidomos në fazën e dytë, ku do të bëhen lista e ngushtë dhe intervistimi i kandidatëve. Të gjithë kandidatëve do t'u bëhen pyetje të natyrës së njëjtë.

Kryetari - Vazhdoi me formimin e panelit duke nënvizuar se gjatë formimit të tij duhet të merren parasysh struktura gjinore dhe e komuniteteve. Paneli do ta ketë përbërjen si vijon: 1. Ramadan Gashi (PDK), 2. Adem Hajdaraj (LDK), 3. Adem Salihaj (LLD), 4. Bransillav Grbiq (SLS), 5. Bajram Kosumi (AAK), Riza Smaka (AKR), 6. Džezair Murati (7+1).

Adem Salihaj - Theksoi se dy femra janë anëtare të Komisionit. Njëra nga ato mund të jetë edhe në këtë panel.

Kryetari - Propozoi që numri i anëtarëve të panelit të jetë nëntë dhe të dy femrat t'i kemi në panel.

Bajram Kosumi - Nënvizoi se sipas rregullave paneli mund të ketë vetëm shtatë anëtarë dhe kërkoi që Komisioni t'u përmbahet rregullave. Duke u ndërlidhur me çështjen e

përfaqësimit gjinor, Bajram Kosumi, propozoi që Komisioni të ketë në panel një anëtare femër.

Ramadan Gashi - U pajtua që paneli t'i ketë shtatë anëtarë.

Riza Smaka - Gjithashtu u pajtua që të jenë shtatë anëtarë.

Pas diskutimeve për këtë pikë, Komisioni mori vendim dhe e miratoi numrin e anëtarëve të propozuar për panel. Paneli për zgjedhjen e Avokatit të Popullit u miratua me gjashtë vota PËR dhe një KUNDËR.

Komisioni njëzëri vendosi që kryetar i panelit të caktohet, Ramadan Gashi.

Komisioni kërkon që të pranishëm gjatë punës së panelit të jenë: stafi mbështetës i Komisionit, si dhe Zyra e Personelit e Kuvendit të Kosovës, për ta ofruar mbështetjen e duhur gjatë procesit të zgjedhjes së Avokatit të Popullit.

4. Njoftim për angazhimin e ekspertëve për shqyrtimin e Projektligjit për procedurën përmbaruese dhe të Projektligjit për procedurën jokontestimore

Kryetari - I njoftoi anëtarët e Komisionit se në takimin me Kryetarin e Kuvendit është diskutuar për çështjen e pagesës së ekspertëve dhe së shpejti do të rregullohet edhe ajo. Ai më tutje nënvizoi se sa u përket Projektligjit për procedurën përmbaruese dhe Projektligjit për procedurën jokontestimore, Instituti Nacional Amerikan (NDI) do t'i mbulojë shpenzimet e ekspertëve të caktuar për këto projektligje, që do t'i sjellin sugjerimet e tyre fillestare në mbledhjen e ardhshme të Komisionit. Kryetari e ngriti çështjen e standardizimit dhe të unifikimit të gjuhëve. I vuri në pah problemet që hasen gjatë punës së shqyrtimit të projektligjeve në Komision, kur projektligjet nuk janë të unifikuara në të tri gjuhë dhe sidomos vështirësitë shfaqen edhe pas amendamentimit të projektligjeve.

Riza Smaka - Propozoi që për këtë çështje Komisioni t'u drejtohet Kryesisë së Kuvendit dhe Qeverisë. Ai propozoi të themelohet një këshill legjislativ me përkthyes profesionistë/juristë që do të merreshin me standardizimin dhe unifikimin e gjuhëve në ligje.

Džezair Murati - U pajtua me propozimin e Riza Smakës dhe paraqiti shembuj konkretë për mangësitë që hasen në shkresat e përkthyer.

Bajram Kosumi - Propozoi që në një nga takimet e Komisionit, për të diskutuar për këtë çështje, të ftohen përfaqësuesit e Zyrës Ligjore të Kryeministrit.

Kryetari - Shtoi se duhet të ftohen edhe përfaqësuesit e Zyrës Ligjore të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Departamentit Ligjor të Kuvendit të Kosovës, ngase Kuvendi e ka edhe Njësinë për Standardizim dhe Harmonizim.

Adem Salihaj - Theksoi se pasi është miratuar edhe Kushtetuta, Kuvendi ta nxjerrë një rregull që do të sqarojë cila do të jetë gjuha bazë për ligjet.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndërmjetësimin

Kryetari - Theksoi se është bërë raporti preliminar për këtë Projektligj dhe është në rregull.

Riza Smaka - U pajtua se Projektligji për ndërmjetësim është hartuar mirë dhe duhet të përkrahet.

Pas shqyrtimit të kësaj pikë, Komisioni njëzëri e miratoi në parim Projektligjin për ndërmjetësimin.

6. Shqyrtimi i projektligjeve për bazë juridike në Kornizën Kushtetuese

Kryetari - Theksoi se për bazë juridike në Kornizën Kushtetuese do të shqyrtohen:

1. Projektligji i produkteve për mbrojtjen e bimëve, 2. Projektligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, 3. Projektligji për vula në institucionet e Republikës së Kosovës, 4. Projektligji për sigurinë private.

Duke u bazuar në përgjegjësitë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, të parashtruara në kreun 5.1 dhe në kreun 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese, vlerësojmë se Projektligji i produkteve për mbrojtjen e bimëve ka bazë juridike në kreun 5.1. (n), Projektligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes ka bazë juridike në kreun 5.1 (i) të Kornizës Kushtetuese, kurse Projektligji për vulat në institucionet e Republikës së Kosovës dhe Projektligji për sigurinë private kanë bazë juridike në kreun 9.1.26 (a) të Kornizës.

Projektligjet u miratuan njëzëri nga anëtarët e Komisionit dhe u kërkua që stafi mbështetës i Komisionit t'i përgatitë rekomandimet.

7. Të ndryshme

Kryetari - Kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të ftohen ekspertët për t'i paraqitur sugjerimet dhe komentet e tyre para Komisionit.

Adem Salihaj - Nënvizoi çështjen e mbajtjes së takimeve të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Ai shtoi se Komisioni i mban 5 deri 6 takime në muaj dhe trajtohet sikur të gjitha komisionet e tjera. Propozoi që për këtë çështje Komisioni t'i drejtohet Kryesisë së Kuvendit.

Anëtarët u pajtuan që për këtë çështje Komisioni t'i drejtohet Kryesisë.

Kryetari i falënderoi edhe një herë të pranishmit dhe e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12:15.

Procesverbalin e hartoi:
Behlul Zeka, zyrtar ligjor

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni